



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr.97	2005	21 dhjetor
--------------	-------------	-------------------

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Ligj nr.9445 datë 16.11.2005	Për disa ndryshime në ligjin nr.8869, datë 22.5.2003 “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”..... 3095
Ligj nr.9446 datë 24.11.2005	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën “Për aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijës”..... 3096
Ligj nr.9447 datë 24.11.2005	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8461, datë 25.2.1999 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar..... 3105
Vendim i Kuvendit nr.11, datë 5.12.2005	Për emërimin e Inspektorit të Përgjithshëm të Bankës së Shqipërisë..... 3106
Vendim i Kuvendit nr.12, datë 15.12.2005	Për ngritjen e Nënkomisionit për Çështjet e Minorenëve dhe Barazisë Gjinore pranë Komisionit të Përhershëm Parlamentar për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë..... 3106
Dekret nr.4718 datë 8.12.2005	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 3107
Dekret nr.4719 datë 8.12.2005	Për lejim lënie të shtetësisë shqiptare..... 3108
Dekret nr.4729 datë 14.12.2005	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 3109
Vendim i GJK nr.33, datë 8.12.2005	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr.1404, datë 6.07.2004 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën..... 3109
Vendim i ERE nr.74, datë 23.11.2005	Për dhënien e licencës për aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe prodhimit të energjisë elektrike, kompanisë “Hidroinvest 1”

	sh.p.k., për Hec Stranik dhe Zall Tore.....	3112
Vendim i ERE nr.75, datë 2.12.2005	Për fillimin e procedurave të shqyrtimit.....	3113
Vendim i ERE nr.76, datë 2.12.2005	Për fillimin e procedurave të shqyrtimit.....	3113
Vendim i ERE nr.77, datë 8.12.2005	Për fillimin e procedurave të shqyrtimit.....	3114
Vendim i ERE nr.78, datë 8.12.2005	Për fillimin e procedurave të shqyrtimit.....	3114
Vendim i ERE nr.79, datë 8.12. 2005	Për fillimin e procedurave të shqyrtimit.....	3115
Vendim i ERE nr.81, datë 16.12.2005	Për dhënien e licencës për aktivitetin e importit të energjisë elektrike shoqërisë GSA. sh.p.k.....	3115
Vendim i ERE nr.82, datë 16.12.2005	Për miratimin e udhëzuesit metodik për vlerësimin nga ERE të investimeve që kryejnë të licencuarit në hidrocentralet me fuqi të instaluar deri në 5 MW, si dhe në H/C e Smokthinës...	3116
Vendim i ERRU nr.9, datë 8.12.2005	Për miratimin e tarifave të largimit të ujërave të ndotura	3119
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Petro Pano Kosta.	3119

L I G J
Nr.9445, datë 16.11.2005

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8869, DATË 22.5.2003
“PËR GARDËN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin nr.8869, datë 22.5.2003 “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Neni 4 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 4

Garda e Republikës së Shqipërisë ruan dhe mbron:

- a) Presidentin e Republikës, Kryetarin e Kuvendit, Kryeministrin, si dhe familjet e tyre;
- b) personalitetet e huaja, të të njëjtit nivel me personalitetet shqiptare të përmendura në shkronjën “a”, që vijnë në vendin tonë, si dhe personalitete të tjera të huaja, për të cilët Ministri i Brendshëm e vlerëson të nevojshme ruajtjen dhe mbrojtjen e tyre;
- c) personalitetet shtetërore vendase, të cilat përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave;
- ç) rezidencat presidenciale, selinë dhe zyrat e Kuvendit të Shqipërisë, selinë e Këshillit të Ministrave dhe mjediset ku vendosen personalitetet e huaja, të përcaktuara në shkronjën “b” të këtij neni;
- d) banesat e personaliteteve të larta shtetërore dhe seli të tjera shtetërore, të cilat përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 2

Neni 5 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 5

- 1. Presidenti i Republikës së Shqipërisë, Kryetari i Kuvendit dhe Kryeministri ruhen dhe mbrohen edhe 3 vjet pas lirimit të tyre nga funksioni.
- 2. Personalitetet e tjera shtetërore vendase, të cilat ruhen dhe mbrohen pas lirimit nga funksioni, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, por, në çdo rast, jo më shumë se 3 vjet pas lirimit nga funksioni.”.

Neni 3

Neni 6 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 6

Garda e Republikës siguron ruajtjen dhe mbrojtjen e objekteve gjatë veprimtarive, ku marrin pjesë Presidenti i Republikës, Kryetari i Kuvendit, Kryeministri dhe personalitetet e përcaktuara në shkronjat “b” e “c” të nenit 4 të këtij ligji.”.

Neni 4

Të gjitha emërtimet “Ministria e Rendit Publik” zëvendësohen me emërtimet “Ministria e Brendshme”.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.4710, datë 5.12.2005 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë
Alfred Moisiu**

L I G J
Nr.9446, datë 24.11.2005

PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË KONVENTËN
“PËR ASPEKTET CIVILE TË RRËMBIMIT NDËRKOMBËTAR TË FËMIJËS”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në Konventën “Për aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijës”, bërë në Hagë më 25 tetor 1980, me rezervën e parashikuar në këtë ligj.

Neni 2

Në përputhje me paragrafin e parë të nenit 6 të Konventës, autoriteti qendror për përmbushjen e detyrave të kësaj Konvente është Ministria e Drejtësisë.

Neni 3

Në përputhje me nenin 42 të Konventës, Republika e Shqipërisë rezervon të drejtën të mos jetë e detyruar të marrë përsipër ndonjë kosto, që parashikohet në paragrafin e tretë të nenit 26 të Konventës, si rezultat i pjesëmarrjes së konsulentit apo konsulentëve ligjorë ose nga procesi gjyqësor, vetëm deri në atë shkallë, që këto kosto mund të mbulohen nga sistemi i asistencës apo konsulencës ligjore.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.4716, datë 8.12.2005 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë
Alfred Moisiu**

KONVENTA
PËR ASPEKTET CIVILE TË RRËMBIMIT NDËRKOMBËTAR TË FËMIJËS
(lidhur në 25 tetor 1980)

Vendet nënshkruese të kësaj Konvente,
tërësisht të bindura se interesat e fëmijëve janë të një rëndësie të veçantë në çështjet që lidhen me kujdestarinë e tyre,

duke dëshiruar mbrojtjen ndërkombëtare të fëmijëve nga pasojat e dëmshme të largimit ose mbajtjes së tyre të padrejtë dhe për të krijuar procedura që sigurojnë kthimin e tyre të menjëhershëm në

shtetin e banesës së tyre të përhershme, si dhe për të siguruar mbrojtje për të drejtat e kontaktit, kanë vendosur të lidhin një Konventë për këtë qëllim dhe kanë rënë dakord për dispozitat e mëposhtme.

KAPITULLI I FUSHA E VEPRIMIT TË KONVENTËS

Neni 1

Qëllimet e kësaj Konvente janë:

a) të sigurojë kthimin e shpejtë të fëmijëve që largohen apo mbahen pa të drejtë në Shtetin Kontraktues;

b) të sigurojë që të drejtat e kujdestarisë dhe të kontaktit sipas ligjit të një Shteti Kontraktues të respektohen efektivisht në Shtetet e tjera Kontraktuese.

Neni 2

Shtetet Kontraktuese duhet të marrin të gjitha masat e duhura për të siguruar brenda territoreve të tyre përmbushjen e qëllimeve të Konventës. Për këtë qëllim, ato duhet të përdorin procedurat më të shpejta të mundshme.

Neni 3

Largimi ose mbajtja e një fëmije konsiderohet i padrejtë në rastet kur:

a) konsiston në shkeljen e të drejtave të kujdestarisë dhënë një personi, një institucioni apo organi tjetër, qoftë kolektivisht apo individualisht, sipas ligjit të shtetit në të cilin fëmija ka qenë banor i përhershëm para largimit apo mbajtjes;

b) në kohën e largimit apo mbajtjes këto të drejta janë ushtruar, qoftë kolektivisht apo individualisht, ose që mund të kenë qenë ushtruar me përjashtim të largimit apo mbajtjes.

Të drejtat e kujdestarisë, të përmendura në nënparagrafin (a) më sipër, mund të lindin veçanërisht nga funksionimi i ligjit ose për shkak të një vendimi gjyqësor apo administrativ ose për shkak të një marrëveshjeje që ka efekt ligjor sipas ligjit të shtetit.

Neni 4

Konventa do të zbatohet për çdo fëmijë që ka qenë banor i përhershëm i Shtetit Kontraktues menjëherë para rastit të ndonjë shkeljeje kujdestarie apo të të drejtave të kontaktit. Konventa do të pushojë së zbatuari kur fëmija arrin moshën 16 vjeç.

Neni 5

Për qëllime të kësaj Konvente:

a) “të drejtat e kujdestarisë” do të përfshijnë të drejtat që lidhen me kujdesin e fëmijës dhe në veçanti, e drejta për të përcaktuar vendbanimin e fëmijës;

b) “të drejtat e hyrjes” do të përfshijnë të drejtën për ta marrë fëmijën për një periudhë të kufizuar në një vend tjetër nga vendbanimi i tij i përhershëm.

KAPITULLI II AUTORITETET QENDRORE

Neni 6

Një Shtet Kontraktues do të autorizojë një autoritet qendror të përmbushë detyrat që Konventa u ka dhënë këtyre autoriteteve.

Shtetet federale, shtetet me më shumë se një sistem ligjor ose shtetet që kanë organizime territoriale autonome, do të jenë të lira të caktojnë më shumë se një autoritet qendror dhe të përcaktojnë shtrirjen territoriale të kompetencave të tyre.

Kur shteti ka caktuar më shumë se një autoritet qendror, do të autorizojë autoritetin qendror, tek i cili mund të dërgohen aplikimet për t'u përcjellë tek autoriteti i duhur qendror brenda këtij shteti.

Neni 7

Autoritetet qendrore do të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin dhe do të nxisin bashkëpunimin midis autoriteteve kompetente në shtetin e tyre përkatës, për të siguruar kthimin e shpejtë të fëmijëve dhe për të arritur objektivat e tjera të kësaj marrëveshjeje.

Në veçanti, qoftë në mënyrë direkte apo me anë të një ndërmjetësi, do të marrin të gjitha masat e duhura:

- a) për të zbuluar vendndodhjen e një fëmije, i cili është larguar apo mbajtur pa të drejtë;
- b) për të parandaluar dëmtimin e mëtejshëm ndaj fëmijës ose paragjykimin te palët e interesuara duke marrë ose bërë që të merren masa të përkohshme;
- c) për të siguruar kthimin e vullnetshëm të fëmijës ose për të arritur një zgjidhje paqësore të çështjeve;
- d) për të shkëmbyer, aty ku duhet, informacion në lidhje me *bekgraundin* social të fëmijës;
- e) për të siguruar informacion të karakterit të përgjithshëm sipas ligjit të shtetit të tyre, në lidhje me zbatimin e Konventës;
- f) për të filluar apo lehtësuar procedimin gjyqësor ose administrativ, me qëllim kthimin e fëmijës dhe në rastin e duhur, të bëjnë përgatitje për organizimin ose sigurimin e ushtrimit efektiv të të drejtave të kontaktit;
- g) siç e kërkojnë rrethanat, të sigurojnë ose lehtësojnë sigurimin e konsulencës dhe asistencës ligjore, duke përfshirë pjesëmarrjen e konsulentëve ligjorë;
- h) të marrin masat e nevojshme administrative, për të siguruar kthimin e sigurt të fëmijës;
- i) të informojnë njëri-tjetrin në lidhje me funksionimin e kësaj Konvente dhe sa të jetë e mundur, të eliminojnë pengesat ndaj zbatimit të saj.

KAPITULLI III KTHIMI I FËMIJËVE

Neni 8

Çdo person, institucion apo organ tjetër që pretendon se një fëmijë është larguar apo mbajtur në shkelje të të drejtave të kujdestarisë, mund t'i drejtohet autoritetit qendror të vendbanimit të përhershëm të fëmijës ose autoritetit qendror të ndonjë Shteti tjetër Kontraktues për asistencë në sigurimin e kthimit të fëmijës.

Aplikimi do të përmbajë:

- a) informacion në lidhje me identitetin e aplikantit, të fëmijës dhe të personit që pretendon se ka larguar apo mbajtur fëmijën;
 - b) kur kërkohet, data e lindjes së fëmijës;
 - c) shkaqet mbi të cilat bazohet pretendimi i aplikantit për kthimin e fëmijës;
 - d) një informacion të nevojshëm në lidhje me vendndodhjen e fëmijës dhe identitetin e personit me të cilin supozohet të jetë fëmija.
- Aplikimi duhet të shoqërohet ose shtohet nga:
- e) një kopje e vërtetuar e ndonjë vendimi apo marrëveshjeje përkatëse;
 - f) një certifikatë apo aktbetim që vjen nga autoriteti qendror ose ndonjë autoritet tjetër kompetent i shtetit të vendbanimit të përhershëm të fëmijës ose nga një person i kualifikuar, në lidhje me ligjin përkatës të këtij shteti;
 - g) çdo dokument tjetër në interes të çështjes.

Neni 9

Nëse autoriteti qendror, i cili merr aplikimin e parashikuar në nenin 8, ka arsye të besojë se fëmija është në një Shtet tjetër Kontraktues, do t'ia transmetojë në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe pa vonesë aplikimin autoritetit qendror të këtij Shteti Kontraktues dhe do të informojë autoritetin qendror kërkues ose aplikantin, në vartësi të çështjes.

Neni 10

Autoriteti qendror i shtetit ku është fëmija do të marrë apo do të nxisë marrjen e masave të nevojshme, me qëllim sigurimin e kthimit të vullnetshëm të fëmijës.

Neni 11

Autoritetet gjyqësore apo administrative të Shteteve Kontraktuese do të shpejtojnë procedurat për kthimin e fëmijëve.

Nëse autoriteti përkatës administrativ apo gjyqësor nuk ka arritur një vendim brenda një periudhe gjashtë javore nga data e fillimit të procedimit, aplikanti ose autoriteti qendror i shtetit të kërkuar, me iniciativën e vet ose nëse i kërkohet nga autoriteti qendror i shtetit kërkues, do të ketë të drejtën të kërkojë një deklaratë për shkaqet e vonësës. Nëse merret një përgjigje nga autoriteti qendror i shtetit të kërkuar, ky autoritet do t'ia transmetojë, sipas rastit, përgjigjen autoritetit qendror të shtetit kërkues ose aplikantit.

Neni 12

Kur fëmija është larguar apo mbahet padrejtësisht, siç është parashikuar në nenin 3, dhe kur në datën e fillimit të procedimit para autoritetit gjyqësor apo administrativ të Shtetit Kontraktues ku është fëmija ka kaluar më pak se një vit nga data e largimit apo mbajtjes së padrejtë, autoriteti i interesuar do të urdhërojë kthimin e menjëhershëm të fëmijës.

Edhe kur procedimet kanë filluar pas mbarimit të periudhës së një viti, siç referohet në paragrafin e mësipërm, autoriteti gjyqësor apo administrativ do të urdhërojë kthimin e fëmijës, për sa kohë që nuk është provuar se fëmija tashmë është vendosur në një mjedis të ri të tij.

Nëse autoriteti gjyqësor apo administrativ në shtetin e kërkuar ka arsye të besojë se fëmija është çuar në një shtet tjetër, mund të shtyjë procedimet ose të pushojë aplikimin për kthimin e fëmijës.

Neni 13

Pavarësisht nga dispozitat e nenit të mësipërm, autoriteti gjyqësor apo administrativ i shtetit të kërkuar nuk është i detyruar të urdhërojë kthimin e fëmijës, nëse personi, institucioni apo organi tjetër që e kundërshton kthimin ose mbajtjen e tij, vendos që:

a) personi, institucioni apo organi tjetër që kujdeset për fëmijën nuk po ushtronin të drejtat e kujdestarisë në kohën e largimit apo mbajtjes ose kanë rënë dakord, ose si rrjedhojë të kenë pranuar në heshtje largimin apo mbajtjen;

b) ekziston rrezik serioz që kthimi i tij ose i saj ta ekspozojë fëmijën ndaj dëmit fizik ose psikologjik ose ta vërë fëmijën para një situatë të patolerueshme.

Autoriteti gjyqësor ose administrativ mund të refuzojë të urdhërojë kthimin e fëmijës, nëse zbulon se fëmija kundërshton të kthehet dhe ka arritur një moshë dhe një shkallë pjekurie, sipas së cilës është në gjendje të vendosë vetë për jetën e vet.

Në marrjen parasysh të rrethanave që i referohen këtij neni, autoritetet gjyqësore dhe administrative do të marrin në konsideratë informacionin në lidhje me bekgraundin social të fëmijës, të siguruar nga autoriteti qendror ose ndonjë autoritet tjetër kompetent i vendbanimit të përhershëm të fëmijës.

Neni 14

Në përcaktimin nëse largimi apo mbajtja ka qenë e padrejtë brenda kuptimit të nenit 3, autoritetet gjyqësore ose administrative të shtetit të kërkuar, mund të marrin në konsideratë drejtpërsëdrejti ligjin dhe vendimet gjyqësore ose administrative, që njihen apo nuk njihen formalisht në shtetin e vendbanimit të përhershëm të fëmijës, pa rekurs ndaj procedurave specifike për provën e këtij ligji ose për njohjen e vendimeve të huaja, që do të zbatoheshin ndryshe.

Neni 15

Autoritetet gjyqësore ose administrative të një Shteti Kontraktues mund të kërkojnë para nxjerrjes së një urdhri për kthimin e fëmijës, që aplikanti të marrë nga autoritetet e shtetit të vendbanimit të përhershëm të fëmijës një vendim se largimi apo mbajtja ishte e padrejtë brenda kuptimit të nenit 3 të Konventës, kur një vendim i tillë mund të merret në këtë shtet. Autoritetet qendrore të Shteteve Kontraktuese do t'i ndihmojnë aplikantët të marrin praktikisht një vendim të tillë.

Neni 16

Pas marrjes së njoftimit për një largim apo mbajtje të padrejtë të fëmijës në kuptimin e nenit 3, autoritetet gjyqësore ose administrative të Shtetit Kontraktues, nga i cili fëmija është larguar apo mbajtur, nuk do të vendosin mbi thelbin e të drejtave të kujdestarisë, derisa të vendoset se fëmija nuk do të kthehet sipas kësaj Konvente ose nëse nuk bëhet një aplikim sipas kësaj Konvente, brenda një kohe të arsyeshme pas marrjes së njoftimit.

Neni 17

Fakti i vetëm që një vendim në lidhje me kujdestarinë është dhënë ose ka të drejtën e njohjes në shtetin e kërkuar, nuk do të përbëjë shkak për refuzimin e kthimit të fëmijës sipas kësaj Konvente, por autoritetet gjyqësore ose administrative të shtetit të kërkuar do të marrin parasysh shkaqet për këtë vendim në zbatimin e kësaj Konvente.

Neni 18

Dispozitat e këtij kapitulli nuk do t'i kufizojnë kompetencat e një autoriteti gjyqësor ose administrativ për të urdhëruar kthimin e fëmijës në çdo kohë.

Neni 19

Një vendim sipas kësaj Konvente në lidhje me kthimin e fëmijës, nuk do të merret si vendim për thelbin e një çështjeje kujdestarie.

Neni 20

Kthimi i fëmijës, sipas dispozitave të nenit 12, mund të refuzohet nëse nuk do lejohej nga parimet themelore të shtetit të kërkuar në lidhje me mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore.

KAPITULLI IV TË DREJTAT E KONTAKTIT

Neni 21

Një aplikim për të marrë masa për organizimin ose sigurimin e ushtrimit efektiv të të drejtave të kontaktit, mund t'u paraqitet autoriteteve qendrore të Shteteve Kontraktuese, në të njëjtën mënyrë siç bëhet aplikimi për kthimin e fëmijës.

Autoritetet qendrore janë të detyruara nga detyrimet e bashkëpunimit, të cilat përcaktohen në nenin 7, të nxisin gëzimin paqësor të të drejtave të kontaktit dhe plotësimin e kushteve në të cilat mund të jetë objekt ushtrimi i këtyre të drejtave. Autoritetet qendrore do të ndërmarrin hapa për të shmangur, sa më shumë që të jetë e mundur, pengesat ndaj ushtrimit të këtyre të drejtave.

Autoritetet qendrore, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë, qoftë me anë të ndërmjetësve, mund të iniciojnë ose ndihmojnë në fillimin e procedimit, me qëllim organizimin ose mbrojtjen e këtyre të drejtave dhe sigurimin e respektimit të kushteve ndaj të cilave mund të jetë objekt ushtrimi i këtyre të drejtave.

KAPITULLI V DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 22

Asnjë siguracion, obligacion apo depozitë, sido që të përshkruhen, nuk do të kërkojë garanci pagese kostosh dhe shpenzimesh në procedimin gjyqësor ose administrativ që janë brenda kompetencave të kësaj Konvente.

Neni 23

Asnjë legalizim apo formalitet i ngjashëm nuk do të kërkohet në kuptimin e kësaj Konvente.

Neni 24

Aplikimi, komunikimi apo ndonjë dokument tjetër i dërguar autoritetit qendror të shtetit të kërkuar do të jetë në gjuhën origjinale dhe do të shoqërohet nga një përkthim në gjuhën zyrtare ose në një nga gjuhët zyrtare të shtetit të kërkuar ose, kur kjo nuk është e mundur, nga një përkthim në frëngjisht ose anglisht.

Megjithatë, një Shtet Kontraktues mundet, duke bërë një rezervë në përputhje me nenin 42, të kundërshtojë përdorimin e frëngjishtes apo të anglishtes, por jo të të dyjave, në ndonjë aplikim, komunikim apo dokument tjetër dërguar autoritetit të saj qendror.

Neni 25

Shtetasit e Shteteve Kontraktuese dhe personat që janë banorë të përhershëm të këtyre shteteve do t'u jepet e drejta për çështje që lidhen me zbatimin e kësaj Konvente për ndihmë dhe konsulencë ligjore në ndonjë Shtet tjetër Kontraktues në të njëjtat kushte sikur ata të ishin vetë shtetas dhe banorë të përhershëm të atij shteti.

Neni 26

Secili autoritet qendror do t'i përballojë vetë kostot për zbatimin e kësaj Konvente.

Autoritetet qendrore dhe shërbimet e tjera publike të Shteteve Kontraktuese nuk do të vënë tarifa në lidhje me aplikimet e dorëzuara sipas kësaj Konvente. Në veçanti, ato nuk mund të kërkojnë ndonjë pagesë nga aplikanti përkundrejt kostove dhe shpenzimeve të procedimit ose, kur është e zbatueshme, ato që rrjedhin nga pjesëmarrja e konsulentit ligjor. Megjithatë, ato mund të kërkojnë pagesën e shpenzimeve të rrjedhura ose që rrjedhin nga mundësimi i kthimit të fëmijës.

Megjithatë, një Shtet Kontraktues mundet të deklarojë, duke bërë një rezervë në përputhje me nenin 42, se nuk do të jetë i detyruar të marrë përsipër ndonjë kosto që parashikohet në paragrafin e mësipërm, si rezultat i pjesëmarrjes së konsulentit apo konsulentëve ligjorë ose nga procesi gjyqësor, vetëm deri në atë shkallë që këto kosto të mund të mbulohen nga sistemi i tij i asistencës apo konsulencës ligjore.

Pas urdhërimit të kthimit të fëmijës ose daljes së urdhrit në lidhje me të drejtat e kontaktit sipas kësaj Konvente, autoritetet gjyqësore ose administrative munden, kur të jetë nevoja, të urdhërojnë personin që largoi apo mbajti fëmijën ose që pengoi ushtrimin e të drejtave të kontaktit, të paguajë shpenzimet e nevojshme që rrjedhin nga ose në emër të aplikantit, duke përfshirë shpenzimet e udhëtimit, ndonjë kosto rrjedhëse ose pagesa të bëra për vendosjen e fëmijës, kostot e përfaqësimit ligjor të aplikantit dhe ato të kthimit të fëmijës.

Neni 27

Kur provohet që kërkesat e kësaj Konvente nuk përmbushen ose që aplikimi nuk është i mirëbazuara, një autoritet qendror nuk është i detyruar të pranojë aplikimin. Në këtë rast, autoriteti qendror do ta informojë menjëherë, sipas rastit, aplikantin ose autoritetin qendror me anë të të cilit u dorëzua aplikimi, lidhur me shkaqet e tij.

Neni 28

Një autoritet qendror mund të kërkojë që aplikimi të shoqërohet nga një autorizim me shkrim duke e autorizuar atë të veprojë në emër të aplikantit ose duke caktuar një përfaqësues për të vepruar.

Neni 29

Kjo Konventë nuk do të pengojë asnjë person, institucion apo organ që pretendon se ka pasur shkelje të kujdestarisë apo të të drejtave të kontaktit brenda kuptimit të neneve 3 ose 21, të aplikojë në mënyrë të drejtpërdrejtë tek autoritetet gjyqësore ose administrative të një Shteti Kontraktues, sipas apo në kundërshtim me dispozitat e kësaj Konvente.

Neni 30

Aplikimi i dorëzuar autoriteteve qendrore ose drejtpërdrejt autoriteteve gjyqësore ose administrative të një Shteti Kontraktues, në përputhje me kushtet e kësaj Konvente, së bashku me dokumentet dhe ndonjë informacion tjetër të bashkëngjitur ose të siguruar nga një autoritet qendror, do të ketë akses në gjykata ose tek autoritetet administrative të Shteteve Kontraktuese.

Neni 31

Përsa i përket një shteti, i cili në çështjet e kujdestarisë së fëmijëve ka dy ose më shumë sisteme të ligjit të zbatueshëm në njësi të ndryshme territoriale:

a) ndonjë referim ndaj banesës së përhershme në këtë shtet do të interpretohet sikur t'i referohej banesës së përhershme në një njësi territoriale të këtij shteti;

b) ndonjë referim ndaj ligjit të shtetit të banesës së përhershme do të interpretohet sikur t'i referohej ligjit të njësisë territoriale në atë shtet ku fëmija banon.

Neni 32

Përsa i përket një shteti, i cili në çështjet e kujdestarisë së fëmijëve ka dy ose më shumë sisteme të ligjit të zbatueshëm në kategori të ndryshme personash, ndonjë referim ndaj ligjit të këtij shteti do të interpretohet sikur t'i referohej sistemit ligjor të përcaktuar nga ligji i atij shteti.

Neni 33

Një shtet, brenda të cilit, njësi të ndryshme territoriale kanë legjislacionin e tyre në lidhje me kujdestarinë e fëmijëve, nuk do të jetë i detyruar të zbatojë këtë Konventë, kur një shtet me sistem të unifikuar ligjor nuk do të ishte i detyruar ta bënte një gjë të tillë.

Neni 34

Kjo Konventë do t'u japë përparësi çështjeve brenda fushës së saj sipas konventës së 5 tetorit 1961, në lidhje me kompetencat e autoriteteve dhe ligjit të zbatueshëm mbi mbrojtjen e minorenëve, si ndërmjet palëve të të dyja konventave. Në rast të kundërt, kjo Konventë nuk do të kufizojë zbatimin e një instrumenti ndërkombëtar në fuqi midis shtetit të origjinës dhe shtetit të adresuar ose ligjit tjetër të shtetit të adresuar për qëllimet e sigurimit të kthimit të fëmijës që është larguar apo mbajtur pa të drejtë ose të organizimit të të drejtave të kontaktit.

Neni 35

Kjo Konventë do të zbatohet midis Shteteve Kontraktuese vetëm në rast largimesh apo mbajtjeve të padrejta që ndodhin pas hyrjes së saj në fuqi në ato shtete.

Kur një deklarament është bërë sipas neneve 39 ose 40, referimi ndaj një shteti kontraktues në paragrafin e mësipërm do t'i referohet njësisë ose njësive territoriale ndaj të cilave zbatohet kjo Konventë.

Neni 36

Asgjë në këtë Konventë nuk do të pengojë dy ose më shumë Shtete Kontraktuese, me qëllim ngushtimin e kufizimeve ndaj të cilave mund të jetë objekt kthimi i fëmijës, nga marrëveshja ndërmjet tyre për të hequr ndonjë dispozitë të kësaj Konvente, e cila mund të nënkuptojë një kufizim të tillë.

KAPITULLI VI DISPOZITAT E FUNDIT

Neni 37

Kjo Konventë është e hapur për nënshkrim për shtetet e përfaqësuara në sesionin e katërmëdhjetë të Konferencës së Hagës mbi të Drejtën Ndërkombëtare Private.

Kjo Konventë i nënshtrohet ratifikimit, pranimit ose miratimit dhe instrumentet përkatëse të ratifikimit, pranimit ose miratimit depozitohen pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme të Holandës.

Neni 38

Çdo shtet tjetër mund të aderojë në këtë Konventë.

Instrumenti i aderimit depozitohet pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme të Holandës.

Konventa do të hyjë në fuqi për një shtet që e ka miratuar ditën e parë të muajit të tretë kalendarik pas depozitimit të instrumentit të saj të hyrjes.

Ky aderim do të ketë efekt vetëm në lidhje me marrëdhëniet midis shtetit aderues dhe shteteve palë që do të kenë deklaruar pranimin e tyre në lidhje me këtë hyrje. Një deklaratë e tillë duhet të bëhet edhe nga çdo shtet anëtar që ratifikon, pranon apo miraton Konventën pas aderimit. Kjo deklaratë do të depozitohet në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Mbretërisë së Holandës.

Kjo ministri do t'i dorëzojë secilit prej Shteteve Kontraktuese një kopje të vërtetuar nëpërmjet kanaleve diplomatike.

Konventa do të hyjë në fuqi midis shtetit aderues dhe shtetit që ka deklaruar pranimin e aderimit të saj ditën e parë të muajit të tretë kalendarik pas depozitimit të deklaratës së pranimit.

Neni 39

Çdo shtet deklaron shtrirjen e efekteve të kësaj Konvente, në të gjithë territorin që ai përfaqëson në nivel ndërkombëtar, apo në një ose disa prej tyre. Kjo deklaratë bëhet efektive në momentin e hyrjes në fuqi të Konventës në atë shtet.

Çdo deklaratë, si dhe çdo shtrirje tjetër e mëvonshme, i njoftohet Ministrisë së Punëve të Jashtme të Holandës.

Neni 40

Nëse një shtet ka dy ose më shumë njësi territoriale në të cilat zbatohen sisteme të ndryshme ligjore në lidhje me çështjet e trajtuara në këtë Konventë, ai mund të deklarojë në kohën e nënshkrimit, ratifikimit, miratimit ose aderimit se Konventa do të shtrihet në të gjitha njësitë territoriale ose vetëm në një ose më shumë prej tyre. Ky shtet mund ta modifikojë këtë deklaratë duke dorëzuar një deklaratë tjetër në çdo kohë.

Çdo deklaratë e tillë do t'i njoftohet Ministrisë së Punëve të Jashtme të Holandës, duke deklaruar shprehimisht njësitë territoriale në të cilat zbatohet kjo Konventë.

Neni 41

Kur Shteti Kontraktues ka një sistem qeverisës, sipas të cilit, pushtetet ekzekutive, gjyqësore dhe legjislative shpërndahen midis autoriteteve qendrore dhe atyre të tjera brenda këtij shteti, nënshkrimi i tij, ratifikimi, pranimi, miratimi, hyrja në këtë Konventë ose bërja e ndonjë deklarate në lidhje me nenin 40, nuk do të sjellë ndërlikime në shpërndarjen e brendshme të pushteteve brenda këtij shteti.

Neni 42

Çdo shtet mundet, në çastin e ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit në këtë Konventë, ose në kohën e paraqitjes së një deklarate në lidhje me nenet 39 ose 40, të paraqesë një ose të dyja rezervat e parashikuara në nenin 24 dhe nenin 26, paragrafi i tretë. Asnjë rezervë tjetër nuk mund të bëhet.

Çdo shtet palë mundet në çdo kohë ta tërheqë këtë rezervë me një njoftim të drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme të Holandës.

Rezerva nuk do të ketë më efekt ditën e parë të muajit të tretë kalendarik, pas njoftimit të referuar në paragrafin paraardhës.

Neni 43

Kjo Konventë do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit të tretë kalendarik, pas datës së depozitimit të instrumentit të tretë të ratifikimit, të pranimit, të miratimit ose të aderimit, referuar në nenet 37 dhe 38.

Më pas ajo do të hyjë në fuqi:

1. Për çdo shtet tjetër palë në proces ratifikimi, pranimi, miratimi ose aderimi ditën e parë të muajit të tretë kalendarik pas datës së depozitimit të instrumentit të ratifikimit, të pranimit, të miratimit ose të

aderimit.

2. Për një territor në të cilin Konventa është shtrirë në përputhje me nenet 39 dhe 40, ditën e parë të muajit të tretë kalendarik, pas njoftimit të referuar në të njëjtin nen.

Neni 44

Kjo Konventë ka një kohëzgjatje 5-vjeçare nga dita e hyrjes në fuqi, në përputhje me paragrafin e parë të nenit 43, përfshi edhe shtetet që e kanë ratifikuar, pranuar, miratuar ose aderuar në të në një datë të mëvonshme.

Nëse nuk ka denoncime, Konventa rinovohet në mënyrë të heshtur çdo pesë vjet.

Çdo denoncim i njoftohet Ministrisë së Punëve të Jashtme të Holandës të paktën 6 muaj përpara përfundimit të periudhës prej 5 vjetësh. Ai mund të kufizohet për disa ose për të tëra territoret në të cilat zbatohet Konventa.

Denoncimi ka efekt vetëm për shtetin që e paraqet. Konventa mbetet në fuqi për shtetet e tjera palë.

Neni 45

Ministria e Punëve të Jashtme të Mbretërisë së Holandës u njofton shteteve palë të Konferencës së Hagës mbi të Drejtën Ndërkombëtare Private, si dhe shteteve që kanë aderuar në përputhje me nenin 38, sa më poshtë:

- a) nënshkrimet, ratifikimet, pranimet dhe miratimet e parashikuara në nenin 37;
- b) aderimet e parashikuara në nenin 38;
- c) datën në të cilën kjo Konventë hyn në fuqi në përputhje me nenin 43;
- d) shtrirjet e parashikuara në nenin 39;
- e) deklaratimet e parashikuara në nenin 38 dhe nenin 40;
- f) rezervat e parashikuara në nenin 24 dhe nenin 26, paragrafi i tretë, si dhe tërheqjet e tyre të referuara në nenin 42;
- g) denoncimet e referuara në nenin 44.

Në dëshmi të kësaj, personat e autorizuar posaçërisht nënshkruajnë këtë Konventë.

Bërë në Hagë, më 25.10.1980, në frëngjisht dhe anglisht, të dyja tekstet njëllor të vlefshme, në një kopje të vetme, e cila do të depozitohet në arkivat e Qeverisë Holandeze, prej së cilës një kopje e vërtetuar i dërgohet nëpërmjet kanaleve diplomatike çdo shteti të përfaqësuar në Sesionin e Katërmëdhjetë të Konferencës së Hagës mbi të Drejtën Ndërkombëtare Private.

L I G J

Nr.9447, datë 24.11.2005

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8461, DATË 25.2.1999 “PËR ARSIMIN E LARTË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin nr.8461, datë 25.2.1999 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen shtesat e ndryshimet si më poshtë:

Neni 1

Në nenin 11 shtohen paragrafët me këtë përmbajtje:

“Departamentet e Fakultetit të Mjekësisë të Universitetit të Tiranës, që janë pjesë e spitaleve universitare, përbëhen nga shërbimet.

Shërbimi është njësi diagnostike dhe trajtuese themelore e spitaleve universitare, që formohet në

bazë të specialitetit dhe/ose në bazë të numrit të shtretërve. Në shërbim kryhet procesi pedagogjik dhe kërkimi shkencor.”.

Neni 2

Neni 12 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 12

Në strukturat e njësive të shkollave të larta përfshihen institutet, qendrat dhe sektorët kërkimorë, laboratorët dhe atelietë mësimore, klinikat, shërbimet mjekësore universitare, studiot, bibliotekat, qendrat sportive, muzetë, feramat eksperimentale, që funksionojnë sipas rregulloreve të brendshme përkatëse.”.

Neni 3

Para fjalisë së fundit të nenit 18 shtohen paragrafët me këtë përmbajtje:

"Në ato departamente të Fakultetit të Mjekësisë të Universitetit të Tiranës, të cilat janë pjesë e spitaleve universitare, përgjegjësi i departamentit përzgjedh për përgjegjës shërbimi, nga stafi pedagogjik i departamentit, ndër kandidatët me kualifikimin shkencor më të lartë. Ai i propozon drejtorit të spitalit universitar 2 kandidatura për çdo shërbim. Drejtori i spitalit universitar emëron përgjegjësit e shërbimeve në departamentet spitalore të Fakultetit të Mjekësisë të Universitetit të Tiranës, pasi të ketë marrë miratimin me shkrim të Dekanit të Fakultetit.

Mosmarrëveshjet për emërimin, të parashikuara në paragrafin e mësipërm, zgjidhen nga Ministri i Shëndetësisë dhe Ministri i Arsimit dhe Shkencës.

Këshilli i departamentit përbëhet nga përgjegjësi i departamentit, përgjegjësit e shërbimeve dhe anëtarët e zgjedhur.”.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.4717, datë 8.12.2005 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë
Alfred Moisiu**

V E N D I M Nr.11, datë 5.12.2005

PËR EMËRIMIN E INSPEKTORIT TË PËRGJITHSHËM TË BANKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të nenit 54 të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, si dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e një grupi deputetësh,

K U V E N D I I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

I. Znj. Teuta Baleta emërohet Inspektore e Përgjithshme e Bankës së Shqipërisë.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**K R Y E T A R E
Jozefina Topalli (Çoba)**

V E N D I M
Nr.12, datë 15.12.2005

**PËR NGRITJEN E NËNKOMISIONIT PËR ÇËSHTJET E MINORENËVE DHE BARAZISË
GJINORE PRANË KOMISIONIT TË PËRHERSHËM PARLAMENTAR PËR PUNËN,
ÇËSHTJET SOCIALE DHE SHËNDETËSINË**

Në mbështetje të neneve 19 pika 2, 21 dhe 22 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Konferencës së Kryetarëve,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

I. Ngrihet Nënkomisioni për Çështjet e Minorenëve dhe Barazisë Gjinore pranë Komisionit të Përherëshëm Parlamentar për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë.

II. Objekti dhe fusha e përgjegjësisë të këtij Nënkomisioni duhet të jenë në përputhje me atë të Komisionit të Përherëshëm Parlamentar për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë, si dhe me Rregulloren e Kuvendit.

III. Objekti dhe fusha e përgjegjësisë së këtij Nënkomisioni janë çështjet që kanë të bëjnë me minorenët, gruan, familjen dhe çështje të barazisë gjinore.

IV. Nënkomisioni përbëhet nga:

- | | |
|-------------------|-----------------|
| 1. Majlinda Bregu | Kryetare |
| 2. Engjëll Bejtaj | Zëvendëskryetar |
| 3. Mehmet Xheka | Anëtar |
| 4. Rajmonda Stefa | Anëtare |
| 5. Leonard Solis | Anëtar |
| 6. Alfred Gega | Anëtar |
| 7. Rrapush Tola | Anëtar |

V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R E
Jozefina Topalli (Çoba)

DEKRET
Nr.4718, datë 8.12.2005

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika “c” të Kushtetutës, të nenit 20 dhe të nenit 9 pika 7 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Magali Isabelle Perrichet Çashku (Perrichet)
2. Laura Jahja Majko (Nila)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Alfred Moisiu

DEKRET
Nr.4719, datë 8.12.2005

PËR LEJIM LËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika “c” të Kushtetutës, të neneve 15, 19 dhe 20 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, bazuar edhe në propozimin e Ministrisë të Rendit Publik,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

- | | |
|------------------------------------|--|
| 1. Anila Bashkim Wilms (Habibi) | 36. Pranvera Xhevat Lozi-Azemi (Lozi) |
| 2. Besnik Avdyl Bundo | 37. Alban Fatmir Azemi |
| 3. Anja Besnik Bundo | 38. Diana Fatmir Azemi |
| 4. Etleva Ramazan Bundo (Kuqi) | 39. Artur Ruzhdi Duraj |
| 5. Gentiana Tajar Çela (Bendo) | 40. Julian Artur Duraj |
| 6. Petrit Murat Canaj | 41. Denis Artur Duraj |
| 7. Spartak Mehmet Zenelaj | 42. Tatjana Mato Duraj (Salaj) |
| 8. Naile Shaqir Schütz (Koçi) | 43. Ena Ali Tiarks (Çinari) |
| 9. Dritan Kol Marku | 44. Mirjan Gjergj Puka |
| 10. Liri Shefqet Lazri (Memoçi) | 45. Samet Mirjan Puka |
| 11. Laura Rajmond Lazri | 46. Kosti Enriko Anastasi |
| 12. Gëzim Hamdi Çela | 47. Violeta Beb Pishtari (Elezi) |
| 13. Altin Hamdi Hoxha | 48. Tessi Llambi Pishtari |
| 14. Alisa Altin Hoxha | 49. Fjoralba Mustafa Turku |
| 15. Megi Altin Hoxha | 50. Mimoza Prokop Bufi (Ciri) |
| 16. Inis Shpëtim Hoxha (Pëllumbi) | 51. Ardian Nazmi Bushati |
| 17. Epidamos Pavlo Golgota | 52. Tesi Ardian Bushati |
| 18. Griseldis Epidamos Golgota | 53. Klea Ardian Bushati |
| 19. Doris Kristo Golgota (Qendra) | 54. Etleva Petrit Bushati (Koplikaj) |
| 20. Gjergji Ligor Plasa | 55. Ardjan Hamit Dika |
| 21. Astrit Myfit Shabanaj | 56. Elvira Gani Pecina (Haxhijahja) |
| 22. Fiqirete Feim Shabanaj (Busha) | 57. Laureta Buser Mang (Jazexhi) |
| 23. Marjola Astrit Shabanaj | 58. Sildi Lorenc Brahimi |
| 24. Aida Astrit Shabanaj | 59. Lindita Musa Theile (Milaqi) |
| 25. Dhurata Xhemal Kemmler (Kuqi) | 60. Xhuljeta Esat Penelli (Torraj) |
| 26. Lucas Martin Kemmler | 61. Flavja Kostandin Penelli |
| 27. Helen Debora Martin Kemmler | 62. Migena Bashkim Doda (Resuli) |
| 28. Lindita Remzi Shkëmbi (Lelo) | 63. Selami Hallkokondi |
| 29. Jürgen Adrian Shkëmbi | 64. Vjollca Refik Hallkokondi (Bylyku) |
| 30. Adela Adrian Shkëmbi | 65. Dorjan Ili Rapi |
| 31. Elvida Adrian Shkëmbi | 66. Arben Fadil Spahiu |
| 32. Hasan Bashkim Kërkhaliu | 67. Bashkim Lush Hima |
| 33. Ledio Plumb Kallashi | 68. Loant Bashkim Baholli |

34. Kastriot Dilaver Sulçe
35. Paskualino Augustin Naraçi

69. Shkëlqim Skënder Maxhaku

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË
Alfred Moisiu

DEKRET
Nr.4729, datë 14.12.2005

PËR DHËNIE TË SHETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika “c” të Kushtetutës, të nenit 20 dhe të nenit 9 pika 7 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”

DEKRETOJ:

Neni 1

I jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tij:
Naim Pajazit Tëmava

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË
Alfred Moisiu

VENDIM
Nr.33, datë 8.12.2005

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë e përbërë nga:

Gjergj Sauli	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Alfred Karamuço	Anëtar i “ “
Fehmi Abdiu	Anëtar i “ “
Kristofor Peçi	Anëtar i “ “
Kujtim Puto	Anëtar i “ “
Vjollca Meçaj	Anëtare e “ “
Petrit Plloçi	Anëtar i “ “
Sokol Sadushi,	Anëtar i “ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i “ “

me sekretare Arbenka Lalica, në datat 19.09.2005, 4.10.2005 dhe 7.11.2005, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me detyrë të hapura çështjen me nr.37 Akti, që i përket:

KËRKUES: KUJTIM SULAJ, përfaqësuar nga avokat Avni Shehu, me prokurë.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

1. SHAQO NOVRUZI
2. PAVLINA NOVRUZI
3. NERTILA E JONILA NOVRUZI, në mungesë.

4. RIZA HICKA, në mungesë.
5. LUÇIJE MOZALI, në mungesë.
6. DOROTEA ZOTO, në mungesë.
7. MARIE ZORBA, në mungesë.
8. MUHAMET BAWAZER, në mungesë.
9. NDËRMARRJA KOMUNALE BANESA TIRANË, në mungesë.
10. KOMISIONI I KTHIMIT DHE I KOMPENSIMIT TË PRONAVE PRANË QARKUT TIRANË, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr.1404, datë 6.07.2004 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën.

BAZA LIGJORE: Nenet 42 pika 2, 131/f, 134/g dhe 142 pika 2 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë.

Kërkuesi ka paraqitur përpara Gjykatës Kushtetuese këto shkaqe kryesore:

- Ka kontradiktë të hapur ndërmjet pjesës arsyetuese dhe urdhëruese të këtij vendimi. Në fund të pjesës arsyetuese deklarohet se: “Për rrethanat e çështjes, vendimi i gjykatës së apelit duhet të lihet në fuqi si i bazuar në ligj”. Megjithatë, në pjesën urdhëruese të vendimit theksohet se duhet prishur vendimi i gjykatës së apelit dhe duhet lënë në fuqi vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
- Gjykimi i çështjes në Kolegjin Civil të Gjykatës së Lartë është bërë pa praninë e kërkuesit.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Xhezair Zaganjori, përfaqësuesin e kërkuesit, subjektet e interesuara, dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Me padinë drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, kërkuesi ka kërkuar pavlefshmërinë e kontratës së shitblerjes së banesës të lidhur ndërmjet Ndërmarrjes Komunale Banesa dhe subjektit të interesuar Shaqo Novruzi, etj. Subjektet e interesuara Shaqo Novruzi etj. me kundërpadi kanë kërkuar anulimin e vendimit të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave nr.61, datë 29.05.1995, me të cilin shtëpia objekt konflikti u jepej motrave Luçije Mozali, Dorotea Zoto dhe Marie Zorba, si trashëgimtare të vetme (ligjore) të të ndjerit Guljelm Luka.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur rrëzimin e padisë dhe pranimin e kundërpadisë. Gjykata e Apelit Tiranë ka pranuar padinë dhe ka rrëzuar kundërpadinë. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, bazuar në nenin 485/c të Kodit të Procedurës Civile, ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Në kërkesën drejtuar Gjykatës Kushtetuese, kërkuesi pretendon se pikërisht vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë ka cenuar të drejtën e tij kushtetuese për një proces të rregullt ligjor.

Gjykata Kushtetuese vlerëson se në këtë rast kemi të bëjmë me gjykimin kushtetues të një ankese individuale, pretendimet e së cilës duhet të analizohen në kuadër të standardeve apo elementeve përbërëse të procesit të rregullt ligjor në kuptim të neneve 42 dhe 131/f të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, si dhe të nenit 6 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut. Nga ana tjetër, ajo e quan të nevojshme të ritheksojë se në këtë kuadër mund të trajtojë edhe probleme të interpretimit dhe zbatimit të ligjit, nëse shkelja që pretendohet, cenon një të drejtë kushtetuese themelore.

Lidhur me pretendimin e parë të kërkuesit, Gjykata Kushtetuese ka parasysh se vendimet gjyqësore që japin gjykatat e të gjitha niveleve në përfundim të gjykimit, përbëjnë aktin procedural kryesor të të gjithë procesit gjyqësor. Ato përmbledhin dhe finalizojnë përfundimisht qëndrimet që mban gjykata lidhur me çështjen në gjykim.

Në nenin 142/1 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë deklarohet qartë shprehimisht detyrimi i gjykatave për të arsyetuar çdo vendim gjyqësor që jepet prej tyre. Kodi i Procedurës Civile përcakton rregulla të sakta për formën dhe përmbajtjen e vendimeve gjyqësore. Nenet 306-309 të këtij Kodi bëjnë fjalë për mënyrën e dhënies së vendimit, si dhe formën e tij. Më tej, në nenin 310 jepet përmbajtja e vendimit të gjykatës. Sipas kësaj dispozite, ky vendim duhet të përmbajë pjesën hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetuese dhe pjesën urdhëruese. Nga ana tjetër, sipas nenit 126 të Kodit të Procedurës Civile, vendimi përfundimtar, si dhe vendimet që i japin fund procesit gjyqësor civil, të parashikuara nga neni 127 i këtij Kodi (vendimet jopërfundimtare), “...duhet të përmbajnë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e

mosmarrëveshjes, ... dhe mënyrën e zgjidhjes së saj”.

Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut, duke iu referuar procesit të drejtë, garantuar në nenin 6 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut, ka theksuar se: “Shtetet gëzojnë liri të konsiderueshme në përzgjedhjen e mjeteve të përshtatshme, të cilat do të garantonin që sistemi i tyre juridik të jetë në përputhje me kërkesat e nenit 6 të Konventës. Megjithatë, gjykatat kombëtare duhet të tregojnë me qartësi të mjaftueshme arsyet mbi të cilat mbështetet vendimi i tyre.”¹

Nga sa sipër, del qartë se vendimi gjyqësor në çdo rast duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij, ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre. Ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat dhe ligjet e mendimit të drejtë. Ato duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie apo kontradiksion të hapur ose të fshehtë. Këto argumente duhet të jenë gjithashtu të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese. Konkluzionet e pjesës arsyetuese duhet të bazohen jo vetëm në aktet ligjore, por edhe në parimet dhe rregullat që karakterizojnë mendimin e shëndoshë e logjik. “E drejta është rregull, dhe e drejta e dhënë logjikisht është e drejtë shumë e mirë”, ka thënë Aristoteli.² Një arsyetim i saktë i vendimit është një mënyrë e sigurt që gjeneron legjitimitet në sytë e të interesuarve. Ky efekt do të jetë akoma më i madh nëse palët do ta përjetojnë këtë vendim si pasojë normale e një procesi të rregullt, në të gjithë komponentët e tij.³

Nga ana tjetër, pjesa urdhëruese e vendimit të gjykatës duhet të jetë rezultat i natyrshëm i përfundimeve të arritura në pjesën arsyetuese. Ajo është sintezë e këtyre përfundimeve dhe si e tillë, në asnjë rast, nuk mund të jetë në kundërshtim me to. Vendimi që përmban ose lejon kontradiktën logjike, cenon rëndë dhënien e drejtësisë. Ai nuk mund të jetë i kuptueshëm dhe bindës dhe për pasojë nuk mund të zbatohet në praktikë. Një vendim i plotë dhe i kuptueshëm pasohet logjikisht edhe me vetë forcimin e sistemit gjyqësor. Ai kontribuon në shprehjen dhe thellimin e vlerave shoqërore që transmetohen përmes normave ligjore”.⁴

Nga dosja gjyqësore rezulton se ka mospërputhje të dukshme ndërmjet pjesës arsyetuese dhe pjesës urdhëruese të vendimit nr.1404, datë 6.07.2004, të dhënë për këtë çështje nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë. Në pjesën arsyetuese nuk gjendet asnjë vlerësim pozitiv apo negativ lidhur me shkaqet e parashtruara nga subjektet e interesuara në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë. Aty vetëm citohen kryesisht disa prej fakteve të pranura në vendimin e dhënë për këtë çështje nga gjykata e apelit dhe në fund të kësaj pjese të vendimit deklarohet shprehimisht se: “Për rrethanat e mësipërme, vendimi i gjykatës së apelit duhet të lihet në fuqi si i bazuar në ligj”. Megjithatë, në pjesën urdhëruese theksohet se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë vendosi: “Prishjen e vendimit... të gjykatës së apelit dhe lënien në fuqi të vendimit ... të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë”.

Shihet qartë se një vendim i tillë, në tërësinë e tij, është alogjik, i pakuptueshëm e, për rrjedhojë, i pazbatueshëm në praktikë. Pikërisht për këtë arsye, kërkuesi dhe subjektet e interesuara, me pretendime të ndryshme përsa i përket pjesës që duhej ndryshuar, kanë kërkuar më pas korrigjimin e këtij vendimi. Por Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.1401/1, datë 17.01.2005 të marrë në Dhomën e Këshillimit, ka vendosur mospranimin e të dyja kërkesave, me arsyetimin se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me: “... gabim material në kuptim të nenit 492 të Kodit të Procedurës Civile”. Për këtë arsye, e vetmja mundësi për goditjen e vendimit nr.1404, datë 06.07.2004 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë mbetet paraqitja e kërkesës në Gjykatën Kushtetuese, me pretendimin e drejtë se, në këtë rast, kemi të bëjmë me proces të parregullt në kuptimin kushtetues.

Përsa më sipër, Gjykata Kushtetuese vlerëson se vendimi që kundërshtohet nga kërkuesi nuk i plotëson standardet që kërkon procesi i rregullt ligjor në kuptimin kushtetues, prandaj duhet të shfuqizohet si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Përsa i përket pretendimit të dytë të kërkuesit, Gjykata Kushtetuese çmon se ai është i pabazuar. Nga dosja gjyqësore rezulton se njoftimi i rekursit të paraqitur nga subjektet e interesuara dhe shpallja e ditës së gjykimit të kësaj çështjeje në Kolegjin Civil të Gjykatës së Lartë, janë bërë në përputhje të plotë me dispozitat respektive të Kodit të Procedurës Civile.

PËR KËTO ARSYE,

1.Çështja Haxhianastasiu kundër Greqisë, Apl. 12945, dt.16.12.1992, si dhe çështja Balani kundër Spanjës, Apl. 18064/91, dt.9.12. 1994

2. Aristoteli: Politika, Libri i shtatë, fq. 180, Botimet Plejad 2003 – Tiranë.

3. Shih Christoph Engel “Inconsistency in Law: In search of a balanced norm”. Bonn, dhjetor 2004, fq.3

4. Po aty.

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 72 e vijues të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

V E N D O S I:

- Shfuqizimin si të papajtushëm me Kushtetutën të vendimit nr.1404, datë 6.07.2004 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.
- Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Kolegjin Civil të Gjykatës së Lartë.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

VENDIM

Nr.74, datë 23.11.2005

**PËR DHËNIEN E LICENCËS PËR AKTIVITETIN E NDËRTIMIT, INSTALIMIT DHE
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, KOMPANISË “HIDROINVEST 1” SHPK, PËR
HEC STRANIK DHE ZALL TORE**

Në mbështetje të nenit 9, si dhe të nenit 13 pika 1 germa a të ligjit nr.9072, datë 22.05.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, vendimit të Këshillit të Ministrave nr.565, datë 12.08.2005 “Për miratimin e marrëveshjes së koncensionit të formës “BOO”, ndërmjet Ministrisë së Industrisë dhe të Energjetikës, Ministrisë së Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, Ministrisë së Bujqësisë dhe të Ushqimit dhe shoqërisë “Hidroinvest” sh.p.k., Çarshovë, Përmet, “Për ndërtimin e hidrocentraleve në Stranik dhe Zall Tore, në Komunën Stravaj, Librazhd”, si dhe vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.44, datë 14.10.2004 “Rregullorja për procedurat e licencimit për centrale elektrike me kapacitet të përgjithshëm jo me të madh se 5 MW”, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 23.11.2005, pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga shoqëria “Hidroinvest 1” sh.p.k.,

KONSTATOI:

Se mungon një pjesë e dokumentacionit sipas “Rregullores për procedurat e licencimit për ndërtimin dhe shfrytëzimin e centraleve elektrike me kapacitet të përgjithshëm jo më të madh se 5 MW”:

1. Vërtetim nga banka për numrin e llogarisë së veçantë për aktivitetin në sektorin e energjisë elektrike (neni 8 germa A pika 8).

2. Deklaratë e aplikuesit nëse i është mohuar apo jo, ose hequr më parë një licencë për prodhimin, transmetimin, shpërndarjen, furnizimin ose eksportin e energjisë elektrike (neni 8 germa B pika 5).

3. Hartë në lidhje me shtrirjen gjeografike të aktivitetit të shoqërisë në sektorin e energjisë elektrike (neni 8 germa D pika 1).

4. Në relacionin teknik nuk jepet informacion mbi jetëgjatësinë e pritshme të centralit (neni 8 germa E).

5. Skema elektrike principale e centralit dhe lidhja e tij me sistemin e transmetimit ose të shpërndarjes (neni 8 germa E).

6. Standardet teknike të pjesëve kryesore të centralit (neni 8 germa E).

7. Lejet e ndërtimit të objektit të licencimit nga organet kompetente të pushtetit vendor (neni 8 germa E).

8. Leja e përdorimit të ujit për prodhimin e energjisë elektrike (neni 8 germa E).

9. Parametrat kryesorë teknikë të rezervuarit, kanalit të derivacionit dhe nyjeve kryesore të tij sipas standardeve të përcaktuara në ligjin nr.8681, datë 02.11.2000 “Për projektimin, ndërtimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e digave dhe dambave” dhe vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 147 datë 18.03.2004 “Për miratimin e rregullores për sigurinë e digave dhe dambave” (neni 8 germa E).

10. Studimi i fizibilitetit me një planbiznesi me të dhëna të hollësishme të kostove për njësi dhe çmimeve në vite, kthimin e investimeve etj.

Duke pasur parasysh detyrimin ligjor nga ana e aplikuesit për plotësimin e dokumentacionit të

nevojshëm, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Shtyrjen e shqyrtimit të aplikimit të shoqërisë “Hidroinvest 1” sh.p.k., deri në plotësimin e të gjithë dokumentacionit të nevojshëm në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

2. Afati kohor për paraqitjen e dokumentacionit nga shoqëria “Hidroinvest 1” sh.p.k. është deri 1 (një) muaj përpara përfundimit të afatit për fillimin e punimeve, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.565, datë 12.08.2005.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S

Pjetër Dema

VENDIM

Nr.75, datë 2.12.2005

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË SHQYRTIMIT

Në mbështetje të nenit 9 dhe nenit 20 pika 1 të ligjit nr.9072, datë 22.05.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe të pikës 1.4 të vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.46, datë 14.10.2004 “Licenca për prodhimin e energjisë elektrike nga centralet elektrike me kapacitet të përgjithshëm jo më të madh se 5 MW”, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 2.12.2005, pasi shqyrtoi për fillim procedure kërkesën e paraqitur nga shoqëria “Korsel” sh.p.k., për kalimin e licencës së prodhimit të energjisë elektrike për hidrocentralet Leskovik nr.1 dhe Leskovik nr.2, të shoqëria “Maksi Elektrik”,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave të shqyrtimit, për kalimin e licencës së prodhimit të energjisë elektrike, për hidrocentralet Leskovik nr.1 dhe Leskovik nr.2, nga shoqëria “Korsel” sh.p.k., të shoqëria “Maksi Elektrik” sh.p.k.

2. Ngarkohet Departamenti i Licencimit dhe Monitorimit, si dhe Departamenti i Çështjeve Ligjore dhe Marrëdhënieve me Publikun për shqyrtimin e kësaj kërkesë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S

Pjetër Dema

VENDIM

Nr.76, datë 2.12.2005

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË SHQYRTIMIT

Në mbështetje të nenit 9 dhe nenit 13 pika 1 germa dh të ligjit nr.9072, datë 22.05.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.26, datë 13.05.2004 “Për miratimin e rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike (ERE), në mbledhjen e tij të datës 2.12.2005, pasi shqyrtoi për fillim procedure kërkesën e paraqitur nga shoqëria “Grupi i Sistemeve Automatike” (GSA sh.p.k.) për licencimin e aktivitetit të importit të energjisë elektrike,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave të shqyrtimit të kërkesës së paraqitur nga shoqëria “Grupi i Sistemeve Automatike” (GSA sh.p.k.) për licencimin e aktivitetit të importit të energjisë elektrike.

2. Ngarkohet Departamenti i Licencimit dhe Monitorimit, si dhe Departamenti i Çështjeve Ligjore dhe Marrëdhënieve me Publikun për shqyrtimin e kësaj kërkesë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Pjetër Dema

VENDIM
Nr.77, datë 8.12.2005

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË SHQYRTIMIT

Në mbështetje të nenit 9 dhe nenit 13, pika 1 germa ç dhe dh, të ligjit nr.9072, datë 22.05.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.26, datë 13.05.2004 “Për miratimin e rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s,” ndryshuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.25, datë 27.05.2005, neni 11 germa A, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 08.12.2005, pasi shqyrtoi për fillimin e procedurave, kërkesën e paraqitur nga shoqëria “Kapital 3” sh.p.k. për pajisjen me licencë të furnizuesit të kualifikuar, si dhe licencë të importit të energjisë elektrike,

VENDOSI :

1. Fillimin e procedurave për shqyrtimin e aplikimit, për licencimin e shoqërisë “Kapital 3” sh.p.k. për aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar, si dhe aktivitetin e importit të energjisë elektrike.

2. Ngarkohet Departamenti i Licencimit dhe Monitorimit, si dhe Departamenti i Çështjeve Ligjore dhe Marrëdhënieve me Publikun për shqyrtimin e kërkesës së paraqitur nga shoqëria “Kapital 3” sh.p.k.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Pjetër Dema

VENDIM
Nr.78, datë 8.12.2005

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË SHQYRTIMIT

Në mbështetje të nenit 9 dhe nenit 26 pika 1 të ligjit nr.9072, datë 22.05.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.26, datë 13.05.2004 “Për miratimin e rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, ndryshuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.25, datë 27.05.2005, neni 11 germa A, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 08.12.2005, pasi shqyrtoi, për fillimin e procedurave, kërkesën e shoqërisë “Wonder Power” sh.a. për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për vitin 2006,

VENDOSI :

1. Fillimin e procedurave për shqyrtimin e aplikimit, për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për vitin 2006, për shoqërinë “Wonder Power” sh.a.

2. Ngarkohet Departamenti i Tarifave dhe Çmimeve për zbatimin e këtij vendimi dhe plotësimin e praktikës së aplikimit në përputhje me rregullat e miratuara nga ERE.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Pjetër Dema

VENDIM
Nr.79, datë 8.12.2005

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË SHQYRTIMIT

Në mbështetje të nenit 9 dhe nenit 26 pika 1 të ligjit nr.9072, datë 22.05.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.26, datë 13.05.2004 “Për miratimin e rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, ndryshuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.25, datë 27.05.2005, neni 11 germa A, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 08.12.2005, pasi shqyrtoi për fillimin e procedurave, kërkesën e shoqërisë “Maksi Elektrik” sh.p.k. për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për vitin 2005, si dhe duke pasur parasysh faktin se kjo shoqëri është e palicencuar,

VENDOSI :

1. Mosfillimin e procedurave të shqyrtimit për përcaktimin e çmimit të energjisë elektrike për vitin 2005, për shoqërinë “Maksi Elektrik” sh.p.k.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Pjetër Dema

VENDIM
Nr. 81, datë 16.12.2005

PËR DHËNIEN E LICENCËS PËR AKTIVITETIN E IMPORTIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE
SHOQËRISË GSA SHPK

Në mbështetje të neneve 9, 13 pika 1 germa dh, 15 pika 1 të ligjit 9072, datë 22.05.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe nenit 5 pika 1 të vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.27, datë 30.5.2004 “Rregullorja për procedurat e licencimit”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike (ERE), në mbledhjen e tij të datës 16.12.2005, mbasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga shoqëria “Grupi i Sistemeve Automatike” (GSA sh.p.k.) për marrje të licensës për aktivitetin e importit të energjisë elektrike,

VENDOSI:

1. Dhënie e licensës shoqërisë GSA sh.p.k. (Grupi i Sistemeve Automatike) për aktivitetin e importit të energjisë elektrike me afat 1 vit duke filluar nga data 26.01.2006.

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Pjetër Dema

VENDIM
Nr. 82, datë 16.12.2005

PËR MIRATIMIN E UDHËZUESIT METODIK PËR VLERËSIMIN NGA ERE TË
INVESTIMEVE QË KRYEJNË TË LICENCUARIT NË HIDROCENTRALET ME FUQI TË
INSTALUAR DERI NË 5 MW, SI DHE NË H/C E SMOKTHINËS

Në mbështetje të neneve 8, pika 2 germa f, 9 dhe 26, pika 1, të ligjit nr.9072, datë 22.05.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike (ERE), në mbledhjen e datës 16.12.2005, pasi shqyrtoi draftin e “Udhëzuesit metodik për vlerësimin nga ERE të investimeve që kryejnë të licencuarit në hidrocentralet me fuqi të instaluar deri në 5

MW, si dhe në H/C e Smokthinës”, të përgatitur nga grupi i punës i ngritur për këtë qëllim,

VENDOSI:

1. Miratimin e udhëzuesit metodik për vlerësimin nga ERE të investimeve që kryejnë të licencuarit në hidrocentralet me fuqi të instaluar deri në 5 MW, si dhe në H/C e Smokthinës” (bashkëlidhur këtij vendimi).

2. Ngarkohet Departamenti i Licencimit dhe Monitorimit të njoftojë të gjithë të licencuarit që janë objekt i zbatimit të kësaj metode.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S

Pjetër Dema

UDHËZUES METODIK PËR VLERËSIMIN NGA ERE TË INVESTIMEVE QË KRYEJNË TË LICENCUARIT NË HIDROCENTRALET ME FUQI TË INSTALUAR DERI NË 5 MW, SI DHE NË H/C E SMOKTHINËS

Autoriteti

Ky udhëzues metodik hartohet në mbështetje të autoritetit që gëzon ERE në bazë të neneve 8, pika 2 germa f, dhe 26 të ligjit nr.9072, datë 22.05.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”.

Baza ligjore

Ky udhëzues metodik është hartuar duke u bazuar në legjislacionin ekzistues në fushën e investimeve, ligjit nr.8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, udhëzimin nr.2 të Këshillit të Ministrave, datë 8.05.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, vendimin e Këshillit të Ministrave nr.444, datë 5.09.1994 “Për tarifat e studimit, projektimit dhe kolaudimit të veprave të ndërtimit”, udhëzimin nr.3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, ligjit nr.8405, datë 17.09.1998 “Për urbanistikën” dhe legjislacionin në fushën e tatimeve.

Përmbajtja

I. Qëllimi dhe fusha e zbatimit

II. Përcaktime për strukturën e investimeve

III. Hapat kryesorë dhe përgjegjësitë në kryerjen e një investimi

IV. Dokumentacioni i nevojshëm shoqërues sipas procedurave për realizimin e investimit

V. Dispozita të fundit

I. Qëllimi dhe fusha e zbatimit

Ky udhëzues metodik ka për qëllim të ndihmojë personelin teknik të ERE-s, si dhe atë të të licencuarve në lidhje me njohjen dhe zbatimin e kërkesave të legjislacionit shqiptar në fuqi, për mbajtjen dhe dokumentimin hap pas hapi të dokumentacionit ligjor, që vërteton kryerjen e investimeve në hidrocentralet e vogla me fuqi të instaluar deri në 5MW, si dhe hidrocentralin e Smokthinës. Ky udhëzues do të shërbejë:

a) gjatë ushtrimit të kontrolleve, për të gjykuar dhe vlerësuar investimet e raportuara nga të licencuarit;

b) për të vlerësuar sa më realisht, në periudhat e aplikimit nga të licencuarit, çmimet e shitjes së energjisë elektrike të prodhuar nga H/C.

II. Përcaktime për strukturën e investimeve

Investimet e kryera në hidrocentrale shërbejnë kryesisht:

- për ndërtime të reja;

- për rikonstruksione, zgjerime dhe përshtatje të objekteve ekzistuese.

Në strukturën e investimeve, për realizimin e ndërtimeve të reja, rikonstruksioneve, zgjerimeve dhe përshtatjeve të H/C ekzistuese parashikohen investimet për:

- studime dhe projekte, duke filluar që nga studimi i leverdisshmërisë së ndërtimit të veprës;

- makineri dhe pajisje (teknologjike dhe të tjera);

- punimet e ndërtimit;

- mbikëqyrja dhe kolaudimi përfundimtar.

III. Hapat kryesorë dhe përgjegjësitë në kryerjen e një investimi

Sigurimi i projekteve dhe preventivave

Punimet për realizimin e investimeve do të realizohen në bazë të projekteve të zbatimit, të cilat, bazuar në nenin 5 të ligjit nr.8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, do të hartohen nga një organizatë projektuese shtetërore ose nga persona fizikë e juridikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencë përkatëse, në bazë të kontratave të hartuara midis palëve.

Projektuesi, si një element i rëndësishëm i projektimit, duhet të hartojë dhe preventivat përkatës, me qëllim që të përcaktojë shpenzimet e domosdoshme për kryerjen e punimeve. Preventivat dhe llogaritjet në to do të bëhen në mbështetje të plotë me projektet e ndryshme të ndërtimit, elektrike, mekanike etj., të zbatimit. Këto konsiderohen dokumentet bazë, nëpërmjet të cilave përcaktohet vlera e plotë e investimit që do të kryhet.

Hartimi dhe llogaritjet e një preventivi do të bëhen konform modeleve dhe rregullave të përshkruara në udhëzimin nr.2 të Këshillit të Ministrave datë 8.05.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”.

Vlerat respektive të studimeve dhe projekteve nuk mund të jenë më të larta se ato të përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.444, datë 5.09.1994 “Për tarifat e studimit, projektimit dhe kolaudimit të veprave të ndërtimit”.

Projektuesi përfshin, si një pjesë të projektit hartimin e listës së furnizimit me pajisje, makineri dhe materiale teknologjike, së bashku me specifikimet teknike dhe sasitë.

Projektuesi mban përgjegjësi për projektet, preventivat dhe specifikimet teknike. Për projektet e ndërtimit të objekteve me vlerë të preventivuar së paku 100 milionë lekë, do të bëhet oponencë teknike e projektit, e cila kryhet nga organizma të përcaktuara në nenin 6 të ligjit nr.8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”.

Kontraktimi dhe lëvrimi për makineri, pajisje dhe materiale teknologjike

Bazuar në listat respektive të furnizimit të pajisjeve, makinerive dhe materialeve teknologjike dhe në specifikimet përkatëse teknike, investitori do të kontrakttojë për prodhimin dhe furnizimin e tyre. Mallrat që vijnë nga jashtë do të shoqërohen sipas përkatësisë me dokumente shoqëruese:

Faturë (Proforma invoice), lista e paketimit (Packing List), certifikatë e origjinës (Certificate of origine). Për pajisjet dhe makineritë duhet të ekzistojnë kompletet e vizatimeve, raportet e testimit, manualët dhe instruksionet e mirëmbajtjes dhe të përdorimit.

Kur blerjet sigurohen brenda vendit si dokument shoqërues do të jetë dhe fatura tatimore.

Për pajisjet dhe makineritë të cilat janë nxjerrë jashtë vendit për riparim dhe janë kthyer përsëri të riparuar duhet të ekzistojnë dokumentet e eksportit të përkohshëm, si dhe dokumentet e kthimit përsëri së bashku me certifikatat e cilësisë.

Kryerja e punimeve të ndërtimit

Në punimet e ndërtimit sipas udhëzimit nr.2, datë 8.05.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit” kreu I, do të kuptojmë dhe do të vlerësohen:

a) Punimet e ndërtimit të parashikuara në projektet ndërtimore, përfshirë dhe rikonstruksionet, zgjerimet dhe përshtatjet (për H/C shih pikën 5 të udhëzimit të mësipërm);

b) Punimet teknologjike dhe të montimit, të parashikuara në projektet teknologjike dhe që përbëhen nga:

- punimet teknologjike;
- punimet e montimit.

Për vlerësimin e punimeve teknologjike dhe të montimit, përcaktimi të bëhet sipas germës B të udhëzimit të sipërpërmendur.

Punimet e ndërtimit do të kryhen nga persona fizikë ose juridikë, privatë a publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencë përkatëse sipas llojit të punimeve që do të kryhen.

Ndërmjet investitorit dhe sipërmarrësit të punimeve do të nënshkruhet kontrata për kryerjen e punimeve ku do të përcaktohen kushtet lidhur me zbatimin e punimeve konform projekteve të zbatimit dhe respektimit të kushteve teknike, cilësisë së materialeve në përputhje me standardet, afatet e përfundimit të punimeve etj.

Mbikëqyrja e punimeve dhe kolaudimi

Mbikëqyrja e punimeve kryhet mbështetur në udhëzimin nr.3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, nëpërmjet një personi/ persona fizikë ose juridikë, të pajisur me licencat përkatëse të jashtme ose nga personeli i investitorit të ngarkuar për mbikëqyrjen e realizimit faktik të punimeve në sasi e cilësi sipas kushteve respektive të projektimit, zbatimit dhe të kontratës të punimeve, si dhe për miratimin e dokumentacionit themelor, si:

- Situacione punimesh, prova të pjesshme të veprës e deri në kolaudimin përfundimtar.

Situacionet e paraqitura nga sipërmarrësi i punimeve në faza të ndryshme të punimeve, si dhe ato përfundimtare kontrollohen dhe miratohen nga mbikëqyrësi i punimeve. Situacioni është dokumenti me rëndësi që pasqyron punën e kryer në fakt, por të parashikuar në projektpreventiv. Kur situacioni paraqitet me ndryshime nga preventivi (të diktura gjatë procesit të zbatimit), krahas situacionit kërkohet të jetë edhe dokumenti i pranimit të këtij ndryshimi nga projektuesi dhe investitori.

Në përfundim të kolaudit të veprës, mbikëqyrësi i punimeve, bazuar në kontratën dhe të gjithë dokumentacionet e tjera, përcakton vlerën përfundimtare të investimit të realizuar. Kjo vlerë i bëhet e ditur sipërmarrësit dhe njoftohet investitori për vlerën përfundimtare të detyrueshme për të paguar.

IV. Dokumentacioni i nevojshëm shoqëruet sipas procedurave për realizimin e investimit

Nr.	Emërtimi i dokumentit	Nënshkruesit
1.	Projektet e zbatimit: - Kontrata investitor-projektues dhe vlefë e bërjes së projektit; - Preventivat e punimeve.	Projektuesi Investitor-projektues Projektuesi
2.	Lista e furnizimit me pajisje, makineri dhe materiale teknologjike, së bashku me specifikimet teknike: - Kontratat e furnizimit sipas përkatësisë; - Faturat (Proforma invoice); - Lista e paketimit (Packing List); - Certifikatë e origjinës (Certificate of origine); - Fatura tatimore (për blerjet në vend); - Dokumentet e eksportit (për riparimet që kryhen jashtë vendit);	Projektuesi Investitor-furnizues Furnizues/prodhuesi Prodhuesi Prodhues /dogana Furnizuesi/prodhuesi Investitori/ dogana
3.	Kontrata për kryerjen e punimeve	Investitor-sipërmarrës
4.	Kontrata për mbikëqyrjen e punimeve	Investitor-mbikëqyrës
5.	Kontrata për kolaudimin e punimeve sipas përkatësisë së punimeve	Investitor-kolaudator
6.	Procesverbal i kolaudit të punimeve	1. Kolaudator-2.Sipërmarrës- 3. Mbikëqyrës Projektues -investitor
7.	Situacionet përfundimtare të punimeve	Sipërmarrës -mbikëqyrës
8.	Faturat e likuidimit të punimeve (sipas përkatësisë)	Investitor

V. Dispozita të fundit

Amendamente të udhëzuesit metodik

Ky udhëzues metodik është objekt rishikimi dhe ndryshimi me vendim të Bordit të Komisionerëve.

Hyrja në fuqi

Ky udhëzues metodik hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

VENDIM

Nr.9, datë 8.12.2005

PËR MIRATIMIN E TARIFAVE TË LARGIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA SHA UJËSJELLËS-KANALIZIME KORÇË

Enti Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe i Largimit e Përpunimit të Ujërave të ndotura, i miraton:

Emri i subjektit:

sh.a. ujësjellës-kanalizime Korçë.

Zona nën juridiksion:

Qyteti i Korçës me 75 mijë banorë.

Tarifa e largimit të ujërave të ndotura, si më poshtë:

Për ujërat e përdorura:

Konsumatori familjar:

11.4 lekë /m³

Institucionet buxhetore: 20.4 lekë/m³

Privatët etj: 26 lekë/m³

Ky vendim hyn në fuqi më 1.1.2006 dhe është i vlefshëm deri në miratimin e tarifave të reja.

KRYETARI
Vladimir Meksi

KËRKESË

Shtetasi Pandeli Kosta, i datëlindjes 1969 dhe banues në Gjirokastrë, i përfaqësuar nga avokat Arjan Sotiri kërkon të shpallet i zhdukur babai i tij Petro Pano Kosta, i datëlindjes 17.1.1936.

KËRKUES
Pandeli Kosta

Fletorja Zyrtare gjendet: duke u abonuar pranë njësive postare të qyteteve ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare; në adresën: Bulevardi Zhan d'Ark, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot" Tel: 042 555 63; 267 468
Për më tepër informacion vizitoni faqen e internetit:
www.legjislacionishqiptar.gov.al ose www.qpz.gov.al

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

REGJISTRAT E NOTERISË SIPAS FORMATIT TË MIRATUAR NGA MINISTRIA E DREJTËSISË 2005

1. REGJISTRI I PËRGJITHSHËM I AKTEVE DHE I VEPRIMEVE NOTERIALE	1500
2. REGJISTRI I TESTAMENTEVE	1200
3. REGJISTRI I DEPOZITIMIT TË PARAVE OSE VLERAVE TË TJERA	1000
4. INDEKSI ALFABETIK	1000

PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI

1. PËR PROKURIMIN PUBLIK.....	1500
2. PËR NËPUNËSIN CIVIL (Botim, 2005)	600
3. PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllim I-rë).....	1500
4. PËR TAKSAT DHE TATIMET.....	1500
1. TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-Korrik 2004 ...	1500
2. TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-Korrik 2004.....	2000

BOTIME TË REJA

1. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllim i II-të)	1500
2. KODI DOGANOR.....	1000
3. KODI DETAR	1000

Doli nga shtypi më 21.12.2005

Tirazhi: 4300 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja "Mësonjëtorja"
Tiranë, 2005

Çmimi 150 lekë